



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.19, datë 25.02.2021

PËR

MIRATIMIN E NDREQJES SË GABIMEVE ME KARAKTER MATERIAL NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAFE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021”

Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket nivelit tregues të tarifës në tabelën nr.25 “Tarifa e zënies së hapësirës publike”, si më poshtë vijon:

TABELA NR.25 “TARIFA E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE”

KATEGORIA DHE NËNKATEGORITË		NIVELI TREGUES I TARIFËS/MUAJ BASHKIA Durrës	NIVELI TREGUES I TARIFËS/MUAJ SUKTH, MANËZ RRASHBULL, ISHËM, K. I RI,
1.	Zënie e hapësirës publike (përdorim sipërfaqe për tavolina)	132 lekë/m ²	66 lekë/m ²
2.	Spektakle ose panairë të ndryshme	132 lekë/m ²	66 lekë/m ²
3.	Mallra jashtë vendit të tregtimit. Objekte të përkohshme me qëllim ushtrim aktiviteti tregtar, (Tezga, Rulot, Ambulant statik ose i levizshëm), sipërfaqet e zëna me platforma të përkohshme,(me material të lehtë, të çmontueshëm që nuk dëmtojnë sipërfaqen ekzistuese), sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativë, kufizime me plastmasë e të tjera, të ngjashme me to.	132 lekë/m ²	66 lekë/m ²

2. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket nivelit tregues të tarifës në tabelën nr 26 “Tarifa e plazheve private”, si më poshtë vijon:


TABELA NR.26 “TARIFA E PLAZHEVE PRIVATE”

QYTETI / NJËSIA ADMINISTRATIVE	Niveli lekë/m ² /sezon turistik
DURRËS, RRASHBULL, ISHËM,	350 lekë/m ² /sezon turistik
KATUNDI I RI (FSHATI RINIA), SUKTH	120 lekë/m ² /sezon turistik

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 25.02.2021




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 173 / prot.
2



Durrës, më 02.03 .2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 19 datë 25.02.2021 Për miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 127 datë 24.12.2020 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

